



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 2458 Prot

Shkodër, më 14.07.2025

V E N D I M

Nr. 207 datë 14.07 2025


"Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë, si dhe programeve të studimeve profesionale për vitin akademik 2025-2026"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3, pika 3/ç, Neni 38, pika 3; Statutit të USH-së, Neni 17, pika 6, germa nj; VKM-së nr.288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë (i ndryshuar), Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 14.07.2025,

Vendosi:

1. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2025-2026, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2025-2026, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit në programet e studimeve profesionale me kohë të plotë, për vitin akademik 2025-2026, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për programin e studimit të formimit të vazhduar me kohë të plotë, për vitin akademik 2025-2026 sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Prof. Dr. Edna Gjura



Shtojca nr 1. Tarifa vjetore e shkollimit për ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2025-2026

 Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	Tarife e plotë tavan studimi (program i parë)	Tarife 50% reduktu	Tarife e plotë studimi (program i dytë)
I. FAKULTETI SHKENCAVE SHOQERORE			
1. Gjuhë-Letërsi	20.000	10.000	50.000
2. Histori	20.000	10.000	50.000
3. Gjeografi	20.000	10.000	50.000
4. Gazetari&Komunikim	20.000	10.000	50.000
5. Histori dhe trashëgimi kulturore	20.000	10.000	50.000
6. Gjeografi dhe zhvillim territori	20.000	10.000	50.000
2. FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA			
1. Gjuhë angleze	20.000	10.000	50.000
2. Gjuhë gjermane	20.000	10.000	50.000
3. Gjuhë italiane	20.000	10.000	50.000
4. Gjuhë frënge	20.000	10.000	50.000
3. FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES			
1. Matematikë	20.000	10.000	50.000
2. Fizikë	20.000	10.000	50.000
3. Biologji-Kimi	20.000	10.000	50.000
4. Informatikë	20.000	10.000	50.000
5. Infermieri e përgjithshme	20.000	10.000	50.000
6. Infermieri Fizioterapi	20.000	10.000	50.000
7. Infermieri Mami	20.000	10.000	50.000
8. Shkencat e Ushqimit	20.000	10.000	50.000
4. FAKULTETI EKONOMIK			
1. Administrim-biznes	20.000	10.000	50.000
2. Financë-Kontabilitet	20.000	10.000	50.000
3. Turizëm	20.000	10.000	50.000
5. FAKULTETI I DREJTESISË			
1. Drejtësi (Bachelor dhe Program i integruar)	25.000	12.500	25.000
6. FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT			
1. Mësuesi për arsimin fillor, klasa I-VI	20.000	10.000	50.000
2. Mësuesi për arsimin parashkollor	20.000	10.000	50.000
3. Psikologji	25.000	12.500	50.000
4. Punë Sociale	25.000	12.500	50.000
5. Edukim fizik&Sporte	20.000	10.000	50.000
6. Pikturë&Grafikë	27.000	13.500	50.000
7. Pedagogji Muzikore	27.000	13.500	50.000

- Studentët, të cilësuar sipas rregulores së Universitetit si përsëritës (viti i parë) i nënshtrohen 100% tarifës vjetore totale të shkollimit.
- Studentët që ndjekin studimet në vit të dytë e të tretë dhe që rezultojnë me notë mesatare mbi 6 (gjashtë), në përfundim të vitit pararendës akademik paguajnë 50% të tarifës totale të shkollimit. Pjesa tjetër (50%) e tarifës totale të shkollimit mbulohet nga granti buxhetit të shtetit.
- Studentët që ndjekin studimet në vit të dytë e të tretë që në përfundim të vitit pararendës akademik që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) paguajnë 100% të tarifës totale të shkollimit.
- Studentët, të cilësuar sipas rregulores së Universitetit si përsëritës i nënshtrohen 100% tarifës totale të shkollimit.

Shtojca nr.2 Tarifa vjetore e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2025-2026

 Master i Shkencave		Fakultet i parë	Fakultet i dytë
	viti akademik	shuma lek	shuma lek
Për çdo program studimi/120 pikë kredite	2025-2026	120.000	120.000
Master i Shkencave në FD	2025-2026	100.000	100.000
Master i Shkencave në Studime regjionale në Gjeografi	2025-2026	100.000	100.000
Master i Shkencave në Studime të historisë dhe kulturës shqiptare	2025-2026	100.000	100.000

Master profesional	viti akademik	Fakultet i parë	Fakultet i dytë
Për çdo program studimi/60 pikë kredite	2025-2026	60,000	72.000

Master profesional	viti akademik	Program i parë	Program i dytë
Për çdo program studimi/120 pike kredite	2025-2026	120.000	144.000
Master Profesional gjuhë angleze	2025-2026	120,000	144.000
Master Profesional gjuhë gjermane	2025-2026	96,000	144.000
Master Profesional gjuhë frënge	2025-2026	96,000	144.000
Master Profesional gjuhë italiane	2025-2026	96,000	144.000
Master Profesional mësuesi histori gjeografi	2025-2026	100,000	100.000
Master profesional mësuesi gjuhë letërsi	2025-2026	100.000	100.000

- Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.
- Studentët, të cilësuar sipas rregulores së Universitetit si përsëritës të vitit akademik i nënshtrohen vetëm tarifës për pikë kredite të diplomës. Tarifa për pikë kredite të diplomës është 500 lekë.
- Studentët që transferojnë studimet nga një program studimi në tjetrin i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.

Shtojca nr.3 Programe profesionale, viti akademik 2025-2026

Program profesional	Shuma lek
Programi profesional "Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike"	20,000
Programi profesional "Specialist i larte elektrik"	20,000
Programi profesional "Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerarëve turistikë për rajonin verior"	40.000

Shtojca nr.4 Programe të formimit të vazhduar, viti akademik 2025-2026

Program i Formimit të vazhduar	Shuma lek
Program i formimit të vazhduar në fushën Psiko Pedagogjike	30,000

